

## I. HYRJE.

Subjekti DANJA 2020 sh.p.k është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti M02521201S. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: ELBASAN, Shalës, Licaj, Zona Kadastrale 2449, pasuria nr.277/2.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: “Tregtim me pakicë të karburanteve, vajrave lubrifikantë, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

Administratori i këtij subjekti është z. Artan Shaipi.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me:

**ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.** (2 depozita nëtokësore me volum 6000 litra)

**ID 1.11 Furnizim për mbushje gazi GLN.** (1 depozitë nëtokësore me volum 500 litra)

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundëshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

## II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.


- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).

- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

### III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

#### 3.1. Vendi ku zhvillohet veprimtaria.

Objekti në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij, subjekti DANJA 2020 SH.P.K., gjendet në krahun e majtë të rrugës automobilistike Belësh-Cerrik drejtimi drejt Cerrikut.



Konceptimi dhe zbatimi i projektit ndërtimor, harmonizon mirë marrëdhëniet në mes veprimtarive që zhvillohen në këtë objekt, duke mos krijuar pengesa në zhvillimin e tyre normal. Çdo njera prej tyre ka lidhje të drejtpërdrejtë me sheshin kryesor të objektit dhe me rrugën automobilistike. Kjo bën që të kemi lirshmëri të pamjes për reklamë, si dhe të lëvizjes së njerëzve e mjeteve që kërkojnë shërbimet e afuara nga ky subjekt.

Objekti është i plotësuar me infrastrukturën e nevojshme inxhinjrike, në bazë të projekteve përkatëse, të miratuara që në lejen e ndërtimit.

*i. Infrastruktura e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.*

Energjia elektrike e nevojshme për zhvillimin e të gjithë aktiviteteve të kësaj pike/stacioni të tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse, merret nga rrjeti përkatës i zonës ku zhvillohet veprimtaria.

Lidhjet me rrjetin furnizues të zonës janë kryer nga specialistët të KESH mbas lidhjes së kontratës përkatëse. Shpërndarja e rrymës elektrike në të gjitha pajisjet elektrike punuese, të ndriçimit të ambjenteve të brendëshme dhe të ambjenteve të jashtme të punës, të rrugëve dhe reklamave, është bërë sipas projekteve elektrike përkatëse dhe nga persona specialistë të fushës. Për të siguruar mos-ndërprerjen e veprimtarisë në rastet e ndërprerje të rrymës elektrike, është instaluar një gjenerator i rrymës elektrike.

I gjithë rrjeti i brendëshëm shpërndarës i rrymës elektrike është i pajisur me sistemet e mbrojtjes, me çelësa e priza, lëshues e matës me parametra teknikë bashkëkohor duke siguruar kështu parametra të një pune pa rrezik të këtij rrjeti, në përputhje me rregulloret përkatëse të shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik.

Tokëzimet e sejcilës prej pajisjeve janë nyje të veçantë dhe në asnjë rast ato nuk janë të përbashkëta dhe nuk dublojnë njera tjetrën. Në asnjë vend nuk kemi përdorim të linjave ajrore, qoftë edhe kablllore.

Në zonat me përqëndrim gazrash, avujsh dhe shkarkimesh teknologjike, tensioni është nën 50 volt dhe ndiçimi është hermetik.

Fuqia elektrike e instaluar e cila plotëson kërkesat e të gjitha veprimtarive që zhvillohen këtu është rreth 15 kWh.

*ii. Infrastruktura e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm.*

Uji i pijshëm merret nga rrjeti përkatës i furnizimit me ujë të pijshëm të zonës ku zhvillohet aktiviteti. Për furnizimin e të gjitha pikave konsumatore të ujit të pijshëm, është ndërtuar një rrjet shpërndarës i ujit me tuba të xinguara, duke e dërguar atë në vendet si zyra, ambjente hidrosanitare, hidrantet që shërbejnë për larjen e objektit si dhe për luftën ndaj zjarreve të mundëshme. Me qëllim që të sigurohet prania e sasive të domosdoshme të ujit gjatë 24 orëve, është instaluar një depozitë uji me aftësi mbajtje 1000 litra. Kjo depozitë është e pajisur me rrjetin e tubacioneve të mbushjes dhe shkarkimit të saj, rrjet ky i pajisur me atrecatuarat e nevojshme si galixhan, valvola moskthimi, sharashineska të llojeve të ndryshme, matës niveli, etj. Në përbërje të kësaj depozite është edhe një pompë uji me fuqi të elektromotorit 0,75 kWh, e cila siguron një presion prej rreth 5 bar dhe sasinë e nevojshme të ujit në hidrante deri në 400

litra/minutë. Vendosja e rrjetit hidrik për shuarjen e zjarrit është kryer në përputhje me standartet e përcaktuara dhe sipas projektit përkatës. Ky rrjet hidrik duhet të mbahet në gjendje të mirë nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme e të rregullta si dhe ndërhyrjeve në kohë dhe cilësore teknike për eliminimin e difekteve të konstatuara.

*iii. Infrastruktura e rrjetit të kanalizimeve nëntokësore dhe e vaskës dekantimit*

E gjithë sipërfaqja e objektit e pa zënë me ndërtime, përshkohet nga një rrjet kanalesh të ndërtuar me beton dhe të mbuluar me rrjetë/zgarë metalike. Si pjesë e këtij rrjeti kanalizimesh janë edhe disa puseta të ndërtuar dhe mbuluar njëlloj si kanalet. I gjithë ky rrjet mbledh ujrë sipërfaqësore apo ujrë e bardha që janë ujrë e shirave apo ujrë që dalin gjatë larjes së këtyre sipërfaqeve, nga punonjësit e shfrytëzimi të kësaj pike. Ky rrjet përfundon në një magjistrë kryesor, tub plastik me diametër 100 mm, i cili i dërgon këto ujra drejtë vaskës së dekantimit me përmasa 2.50 x 1.50 x 1.40 m ku realizohet procesi i dekantimit dhe ndarjes së grimcave të lëndëve djegëse që mund të mbartin këto ujra, në bazë të dendësisë (peshës specifike) të tyre. Ujrë që dalin nga vaska e dekantimit shkarkohen në separatorin, i cili i shkarkon ujrë e trajtuar në rrjetin e kanalizimeve të zonës urbane. Në këtë rrjet bëhet edhe shkarkimi i ujërave të zeza të objektit me anë të tubaci plastik PVC 120 mm, i cili lidhet me magjistrë kryesor të zonës.

*iv. Infrastruktura e rrjetit të tokëzimeve.*

Është e domosdoshme, që pikat/stacionet e magazinimit dhe të tregtimit të naftës, benzinës dhe të GLN duhet të pajisen dhe me një rrjet funksional të tokëzimeve. Ky rrjet tokëzimesh përfshin, rezervuarët e lëndëve djegëse, pompën distributore, godinat, reklamën, tetojën etj. Në përbërje të këtij rrjeti tokëzues janë:

- një rrjet rrufe – pritësesh të plotësuar me rrjetin shkarkues të tyre;
- rrjeti i tokëzimit të pajisjeve elektrike, elektromotorrë, ndriçues, lëshues, etj.
- rrjeti i lidhjes së fllanxhave bashkuese të sharashineskave apo tubacioneve ku kalon lëndë djegëse.

I gjithë rrjeti apo sistemi i tokëzimit të instaluar testohet peroidikisht për provën e shkarkimit të rrymës elektrike në tokë. Rezistenca elektrike e këtij rrjeti tokëzues nuk duhet të jetë më e madhe se 0.5 Om.

*v. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit.*

Në të gjithë veprimtaritë ky kryhet magazinimi dhe tregtimi i çdo lloji lëndë djegëse, është e domosdoshme të ndërtohet një sistem i mbrojtjes nga zjarri. Krahas ndërtimit të një sistemi të tillë, është po kaq e domosdoshme edhe trajnimi i punonjësve për të mësuar mënyrën e funksionimit të pajisjeve të luftës ndaj zjarrit. Zakonisht në përbërje të sistemeve të tilla futen aparate zbullimi dhe sinjalizimi të pranisë së gazeve të djegëshëm në ambientet e punës (jashtë pajisjeve punuese), fikse zjarri të llojeve dhe madhësive të ndryshme, rezervarë dhe hidrante uji, tabela paralajmëruese e sinjalizuese, etj.

Në këtë objekt janë instaluar hidrante murale të fikjes së zjarreve të mundëshme si dhe janë vendosur disa fikse me pluhur dhe me shkumë të lëvizëshme dhe stacionare.



Rrjeti hidrik i jashtëm për fikjen e zjarreve ku përfshihen edhe hidrantet, zbatohet apo shfrytëzohet për të mbrojtur objekte dhe hapësirat përreth tyre të kësaj pike karburanti nga zjarret e mundëshme. Ky rrjet hidrik i jashtëm, përbëhet nga rezervuari i ujit, pompa, hidranti dhe rrjeti i tubacioneve lidhëse të tyre përfshi këtu edhe atrecaturat e nevojshme. Hidranti i vendosur në këtë objekt është i tipit DN45 i kompletuar me tub najloni me gjatësi 20 metra, me hedhëse uji dhe është i futur në një kuti metalike me ngjyrë të kuqe. Lartësi e vendosjes së hidrantit nga toka është 1.25 metra, lehtësisht i dallueshëm dhe i manovrueshëm nga punonjësit e kësaj pike karburanti. Hidranti hedh ujë në një distancë prej 30-35 metrash duke garantuar mbulimin e puthuajse të të gjithë sipërfaqes së këtij objekti.

Në vendqëndrimin e personelit dhe në zyrën e punës së tij janë vendosur respektivisht nga një fikse zjarri dore, me pluhur me vëllim 6 kg ndërsa në distributorin e shitjes së naftës dhe të benzinës është vendosur një fikse zjarr dore me pluhur me vëllim 9 kg. Këto fikse zjarri janë vendosur në mure nga ana e varësës në një lartësi rreth 1.5 metra nga dysHEMEJA dhe janë lehtësisht të dallueshme e të përdorëshme nga personeli I kësaj pike karburanti.

Në këtë pikë karburanti gjenden edhe dy fikse zjarri të lëvizëshme mbi rrota të tipit S-50, me vëllim 50 litra sejcilia, të vendosura respektivisht një në distrubori I naftës dhe benzinës dhe një tek distributor I GLN-së.

Këto pajisje duhet të përdoren me kujdes dhe në vendet dhe menyrën e duhur për të dhënë suksesin e pritshëm.

#### vi. Ambjentet hidro-sanitare.

Në këtë pikë tregtimi të naftës, benzinës dhe të GLN, janë ndërtuar edhe dy ambjente hidro-sanitare, funksionale për secilin prej tyre. Ato janë ndërtuar dhe plotësuar me pajisjet e duhura bashkëkohore, duke krijuar dhe plotësuar të gjitha standardet dhe kushtet higjeno-sanitare.

#### vii. Rrugë dhe sheshe pune.

Ky stacion i magazinimit dhe tregtimt të naftës, benzinës dhe GLN-së, është i lidhur me rrugën automobilistike kombëtare Belësh – Cerrik, me dy degëzime, të shtruara me asfaltobeton të cilat i shërbejnë veprimtarive të caktuara. Nëpërmjet këtyre dy degëzimeve rrugore, bëhet hyrja dhe dalja normalisht e automjeteve që vijnë në këtë objekt për t'u furnizuar me lëndë djegëse.

### **3.2 Përshkrimi i proceseve teknologjike**

Zhvillimi i këtijë aktiviteti ka të bëjë me magazinimin dhe e tregëtimin me pakicë të naftës, benzinës dhe G.L.N. dhe për këtë arsye ne do të trajtojmë në mënyrë të hollësishme projektet teknologjike që kanë të bëjnë me naftën, benzinën dhe G.L.N. e këtij stacioni.

i. Platforma e përbashkët e vendosjes së rezervuarve nëntokësorë të magazinimit të naftës dhe të benzinës.

Në këtë platformë janë vendosur dy rezervuarë cilindrik hermetik me aftësi mbajtëse naftë/benzene rreth 3000 litra. Rezervuarët janë të vendosur në pozicionin horizontal mbi jastëkë betoni të markës së lartë, të cilët i rezistojnë shtypjes së ushtruar nga pesha e rezervuarëve dhe e

lëndës djegëse të depozitur në to. Ato fiksohen/kapen me jastëkët mbështetës me anë të fashetave metalike, të cilat janë kapur me vida/bulona.

Në dyshemenë e gropës së rezervuarve është ndërtuar një sistem pusetash të cilat shërbejnë për të mbledhur e ujërat që vijnë nga shirat, larja e objektit apo rrjedhat nëntoksore. Gjithashtu këto puseta mbledhin edhe naftën apo benzinën e derdhur aksidentalisht nga dëmtimet e rezervuarëve apo pajisjeve të tyre. Me anë të një pompe vertikale, këto ujra dërgohen në vaskën e dekantimit.

Gropa ku janë rezervuarët mbulohet me kapakë prej betoni duke formatuar mbi to të hapur një dritare kontrolli me përmasa 1 x 1 m. Kjo hapsirë vishet me një kornizë metalike të pregatitur me profil L 10x10 mm, në të cilën rrëshqasint cilindrat e shinës së kapakut metalik mbyllës të platformës së rezervuarve. Ky kapak qëndron gjithëkohës i kyçur nga personeli dhe hapet na mënyrë periodike për të bërë kontrole të gjendjes së rezervuarëve dhe pasijeve të tjera të vendosura në këtë platformë.

Mbi çdo rezervuar të magazinimit të lëndës djegëse është ndërtuar një dalje tip pusete prej betoni, brenda së cilës është vendosur linja e mbushjes së rezervuarit. Mbas montimit të rezervuarëve, ata janë mbuluar me tokë argjilore, rërë dhe zhavor lumi me trashësi prej 0.7 m nga tangjentja ekstreme e sipërme e rezervuarve. Kjo shtresë (përzjerje argjil, rërë dhe zhavori) shërben si mbulesë mbrojtëse duke minimizuar kontaktet dhe luhatjet e temperaturave të cilat mund të shkaktojnë aksidente, veçanërisht në verë.

## ii. Rezervuarët e depozitimit të naftës dhe të benzinës.

Të 2 rezervuarët e magazinimit të naftës dhe benzinës janë pregatitur me llamarinë çeliku. Sipërfaqja e jashtme e tyre është lyer me bojë bituminoze anti-korrozion, përpara vendosjes së tyre në gropë.

Sejcili prej rezervuarëve është i pajisur me bokaportën/kapakun e tij. Në këta bokaporta/kapakë janë stampuar të dhënat specifike dhe teknike të rezervuarit. Bokaporta/kapaku është i vendosur mbi pjesën e sipërme të rezervuarit duke e mbyllur atë në mënyrë hermetike të plotë, nëpërmjet guarnicionit dhe shtëngimit me bullona.

Në kapakun e çdo rezervuari janë instaluar të gjithë pajisjet e nevojshme të tij:

- a. Valvola e sigurimit ose “e frymëmarrjes” ose tubat e ajrimit. Për të shkarkuar mbingarkesat e presionit të brendëshëm të rezervuarit (mbi presion ose vakum), si dhe nga ndryshimet e temperaturës së ambientit, të cilat mund të lindin gjatë procesit të mbushjes apo të zbrazjes së rezervuarit me lëndën djegëse përkatëse, ato janë të pajisur me një prej elementëve të sigurisë së mësipërme. Në këtë mënyrë rezervuari ka komunikim me atmosferën jashtë tij, duke eliminuar mbingarkesat e presionit brenda tij.
- b. Sistemi i aparaturave të kontrollit dhe matjes së nivelit të mbushjes së rezervuarit, të presionit të gazeve në sipërfaqen e lirë të tij. Me anë të këtij sistemi bëhet i mundur kontrolli në çdo kohë nga personeli shfrytëzues, i sasisë së lëndës djegëse që gjendet në rezervuar duke planifikuar kështu mundësinë e furnizimit të radhës.
- c. Valvola e moskthimit të lëndës djegëse. Kjo pajisje shërben për mos kthimin e lëndës djegëse në rezervuar, në kohën kur del nga puna pompa që nxjerr lëndën djegëse nga ky

rezervuar. Në këtë mënyrë tubacionet përkatëse të lëndës djegëse mbeten gjatë gjithë kohës të mbushura duke lehtësuar punën normale të pompës.

- d. Filtri i lëndës djegëse, shërben për të bërë filtrimin e lëndës djegëse gjatë kohës së punës së pompës. Zakonisht pas një periudhe kohe të shfrytëzimit të rezervuarit, në fundin e tij dekantojnë mbetje të ngurta, kondensate, etj. shoqëruese të lëndës djegëse për shkaqe nga më të ndryshmet. Vendosja në punë normale e këtij filtri bën mbrojtjen e pompës dhe të tubacioneve nga prania e këtyre lëndëve dhe njëkohësisht nuk prish treguesit cilësor të lëndës djegëse.
- e. Sistemi i tubacioneve dhe sarishineskave të vendosur në to. Ky sistem tubacionesh shërben për furnizimin e rezervuarit me naftë ose benzinë si dhe për shkarkimin e tyre. Sarishineskat lidhen me fllanxha me tubacionet përkatëse dhe shtërngohen me bullona. Hapja dhe mbyllja e tyre bëhet me dorë nëpërmjet instrumentave specifike dhe vetëm nga personel i autorizuar dhe i specializuar.

i. Mbushja e rezervuarve me lëndë djegëse të përcaktuar.

Lëndët djegëse naftë dhe benzinë vijnë në këtë stacion të tregtimit me pakicë të tyre me anë të autoçisternave të posaçme. Autoçisternat lëvizin në hapësirën e brendëshme sipas rregullave të sigurisë dhe parkohen pranë nyjes së shkarkimit. Ato lidhen me sistemin e tokëzimit të ndërtuar posaçërisht për to. Shkarkimi i lëndës djegëse, bëhet nëpërmjet linjave të instaluar për këtë proces, të pajisura me atrecaturat e duhura, hermetike duke krijuar kështu garancitë e nevojshme për punë të sigurtë, shmangien e aksidenteve dhe rrjedhjeve të lëndës djegëse jashtë tyre. Duhet të tregohet kujdesi maksimal gjatë këtij procesi duke patur parasysh që mbushja maksimale e tyre rekomandohet të jetë:

- për benzinën deri në 90 % të vëllimit gjeometrik,
- për naftën deri në 95 % të vëllimit gjeometrik,

Vëllimi i punës së rezervuarit është kështu më i vogël nga vëllimi i tij gjeometrik, në mënyrë që të lejojë një boshllëk të mjaftueshëm për të kompesuar rritjen e nivelit të produktit të depozituar, për shkak të rritjes së temperaturës së tij.

ii. Sistemi i furnizimit me naftë ose benzinë i automjeteve.

Ky sistem përbëhet nga katër pompa të vendosur nën tentojë, në dy rrjeshta paralele, dy për naftë dhe dy të tjera për benzinë.

Çdo pajisje furnizuese, ka nga dy pistoleta furnizuese të automjeteve dhe vendosja e tyre në pajisje është e tillë, që lejon të punohet në të dy krahët/anët e pajisjes, duke bërë të mundur furnizimin e dy automjeteve njëkohësisht. Kjo bën të mundur kryerjen e një shërbimi të shpejtë dhe zvogëlon kohën e qëndrimit të automjeteve për furnizimit. Pajisjet furnizuese të vendosura, kanë këto tregues teknik e cilësor:

- I gjithë sistemi i pajisjes (pompa, tubot e gomës dhe ato të inoksit, pistoletat e mbushjes, etj.) siguron hermetizim të plotë pa lejuar rrjedhje të lëndës djegëse jashtë tyre.
- Elektromotori i pompës është plotësisht hermetik dhe me lidhje të shkurtër duke mos lejuar futjen e avujve të lëndës djegëse brenda tij, duke shmangur kështu shkaqet për avari të mundshme.

- Në përbërje të këtij sistemi është edhe një kundra-valvul e cila pengon kthimin e lëndës djegëse në drejtim të kundërt të thithjes së pompës.
- Sistemi i matjes së sasisë së lëndës djegëse që shkon në automjet është i pajisur me një paketë elektronike, me ekran të ndriçuar në çdo kohë, siguron dhënien e saktë të sasisë së kalimit, dhe është i pajisur me një mekanizëm të fshirjes së leximit të mëparshëm të shifrave të dhënies së radhës së mëparshme.
- Pistoleta furnizuese është e pajisur me një valvol të dyfishtë e cila komandohet lehtësisht me dorë, nga punonjësi. Pistoleta ndalon në mënyrë automatike rrjedhjen e lëndës djegëse nëpër të, në rastin e tejmbushjes së sabratorit të automjetit duke shmangur kështu derdhjen e lëndës djegëse në këtë ambient pune.
- Dhënia/shitja e çdo lënde djegëse bëhet me litra, në sasi të kontrollueshme në çdo kohë, sipas kalibrimeve standarte të bëra nga personel i specializur dhe i licencuar.

I gjithë ky sistem, i përshkruar më sipërm i është nënshtruar prova të qëndrueshmëri mekanike dhe të hermeticitetit, njëjloj si rezervuarët.

iii. Rezervuari i magazinimit të gazit të lëngëzuar të naftës (G.L.N.).

Rezervuari i magazinimit të gazit të lëngët (GLN) ka formë cilindrike me dimensione; diametër 1.2 m dhe gjatësi 4.7 m, duke patur kështu një vëllim gjeometrik prej rreth 5 m<sup>3</sup>. Temperatura e punës është në intervalin -40 deri + 50 °C ndërsa presioni i punës është 17.65 bar. Distanca e vendosjes së tij në lidhje me rezervuarët e lëndës djegëse dhe objektet e tjera të pikës/stacionit kënaq kërkesat e rregullores përkatëse të miratuar nga Ministri i Energjitikës.

Rezervuari i G.L.N. është vendosur mbi tokë, mbi një konstruksion metalik me lartësi nga toka rreth 0,75 m. Sipërfaqja e truallit nën këtë rezervuar, është shtruar dhe izoluar me beton. Ajo është plotësisht pa gropa dhe në formën e një hinke, duke siguruar kështu mos grumbullimin apo mbajtjen e gazit që mund të rrjedhe në rastet e aksidenteve të mundëshme.

Rezervuari është i lyer nga jashtë me bojë me ngjyrën karakteristike të rezervuarëve të gazit, e cila e mbron atë nga agjentët atmosferikë si dhe nga rrezatimi diellor. Njëkohësisht ai është i mbrojtur nga një mbulesë e përgatitur nga material që mbron atë nga ngrohja diellore.

Në këtë rezervuar janë instaluar këto paisje:

- matësi i presionit të G.L.N.
- matësi i temperaturës të G.L.N.
- matësi i sasisë të G.L.N.
- valvola e presionit apo e sigurisë,
- pajisja për largimin e ajrit nga rezervuari,
- filtrat e gazit,
- pajisjet e shkarkimit të kondensatit,
- etj.

iv. Mbushja e rezervuarit dhe e bomblave të automjeteve e me G.L.N.

GLN sillet në këtë pikë/stacion me anë të auto-çisternave G.L.N Punonjësit me eksperiencën e mjaftueshme të kryejës së këtij procesi teknologjik, bëjnë lidhjen e auto-çisternës me rezervuarin



e G.L.N, dhe vijojnë nën një kontroll të vijushëm të të gjithë parametrave teknik në mënyrë të veçantë të presionit dhe temperaturës, kalimin e GLN nga mjete në rezervuar.

Ato ndërhyjnë në proces duke rregulluar e mbajtur këto parametra në vlerat e tyre normale të përcaktuara nga rregullat e shfrytëzimit dhe të mbrojtjes në punë. Nëse ndodh rritje e temperaturës, menjëherë vihet në punë sistemi i ftohjes me ujë të sipërfaqes së jashme të rezervuarit. Është një sistem i thjeshtë që, përbëhet nga një tub çeliku me diametër rreth  $\frac{3}{4}$  inxh i cili përshkon të gjithë gjatësinë e rezervuarit paralel me aksin gjatësor të tij. Në këtë tub janë shpuar bira me diametër 1-2 mm, nëpër të cilat kalon uji me presion duke formuar kështu një dush uji të freskët i cili mbulon të gjithë sipërfaqen e jashme të rezervuarit duke bërë të mundur uljen e temperaturës së gazit brenda tij.

Ky rezervuar nëpërmjet një sistemi tubash inoksi është i lidhur me pompën dhe pistoletën e furnizimit, në të cilën është montuar dhe dozatori elektronik. Në këtë mënyrë bëhet mbushja me GLN e bombolave të automjeteteve, duke bërë edhe matjen e sasisë së GLN të furnizuar. Pajisjet matëse kolaudohen dhe kontrollohen në mënyrë të vazhduar me qëllim që të sigurohet funksionimin normal i tyre si dhe të eliminohen mundësitë e rrjedhjeve së GLN jashtë pajisjeve punues. Kështu shmangim jo vetëm praninë e GLN në ambjentet e punës me erën e tij karakteristike por, edhe eliminojmë rreziqet e mundëshme të rënies së zjarreve apo dëmtime të shëndetit të punonjësve.

Tubi i futjes së GLN në rezervuar përveç ventilin mbyllës me dorë ka edhe një valvol moskthimi ose një valvol të komanduar në distancë të lidhur drejtpërsëdrejti me rezervuarin.

Tubi i marrjes së GLN në rezervuar përveç ventilin mbyllës me dorë ka edhe një valvol të tejkalimit të rrymës ose një valvol të komanduar në distancë.

Tubat e lidhur drejtpërsëdrejti me rezervuarin për pastrimin e tyre ose për marrjen e kampionëve janë të pajisur me dy ventila mbyllës me dorë njeri pas tjetrit, në distancë jo më pak se 0,60 metra ndërmjet tyre.

Skaji i lirë i tubacionit të pastrimit largohet në zonën e sigurisë, të paktën 1 m larg projektionit horizontal të rezervuarit.

## **IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse.**

### **4.1. Lëndët e para.**

#### a) Nafta dhe Benzina.

Avullimet e produkteve të naftës janë në përgjithësi pa ngjyrë, kanë erë por nuk është e mundur të përcaktohet përqëndrimi i avujve brenda kufinjve të ndezjes. Sasi të vogla avullimesh të produkteve të naftës në ajër mund të formojnë përzjerje që ndizen lehtë nga një flakë element i nxehjes, shkëndije, ose arsyeje tjetër ndezjeje.

Avullimet e produkteve të naftës që çlirohen nga depozitat/ rezervarët janë më të rënda se ajri. Në rastet e rrjedhjes ose të derdhjes së produkteve të naftës, avullimet e tyre do të përhapen në sipërfaqen e tokës ose nëpërmjet kanalizimeve të kullimit do të grumbullohen në kuotat më të ulta të ambjentit për rreth. Mungesa e qarkullimit/lëvizjes së ajrit e zgjat kohën e përhapjes së tyre në këto ambjente.

Produktet e naftës janë më të lehta se sa uji dhe janë të transportueshme prej tij. Kështu që përdorimi i ujit të zakonshëm për shuarjen e zjarrit mund t'a përhapë më shumë atë.

Produkteve të naftës janë të djegëshme, ato kthehen lehtësisht në gaze, duke u përzjerë me ajrin. Raporti i përzjerjes ndërmjet tyre në kufinj të 1 deri 8 % vlerësohet përzjerje ndezëse. Përzjerja, jashtë këtyre vlerave nuk mund të ndizet.

Avullimet e çdo lloj produkti të naftës në përqëndrime të larta mund të shkaktojnë helmime, nëse përmbajtja e oksigjenit zbret nën 18 %.

b) Gazi i lëngëzuar i naftës GLN.

Për përdorim të përgjithshëm shfrytëzohen dy lloje gazi të lëngëzua, BUTAN dhe PROPAN ose përzjerje e tyre. Treguesit cilësor të këtyre gazeve tregohen në tabelën në vijim.

Nr	Emërtimi	Njësia	BUTAN	PROPAN	Shënime
1	Pesha specifike	ton/m <sup>3</sup>	0.582	0.504	në temp. 15.5 °C
2	Vëllimi i 1kg gaz	m <sup>3</sup>	0.410	0.539	në temp. 15.5 °C
3	Pesha e 1 m <sup>3</sup> gaz	kg	582	504	në temp. 15.5 °C
4	Temp. vetëndezjes	°C	482-538	493-549	
5	Raportet ajër/gaz të përzjerjes plasëse		1.55	2.15	kufiri i sipërm
			8.60	9.60	kufiri i poshtëm

Gazi në gjendje të lëngët është pa ngjyrë dhe pesha e tij është pothuajse sa ½ e peshës të të njëjtit vëllim uji. Avujt (faza e dytë) e gazit të lëngëzuar janë më të rëndë se ajri. Butani për treg ka pothuajse dyfishin e peshës, për të njëjtin volum ajri. Përqindja e vëllimit të fazës së gaztë (gazit të lëngëzuar) me ajrin që krijon përzjerje plasëse është 2 – 10 %. Për shkak të karakteristikave përkatëse çdo përzjerje ajër-gaz, mund të ndizet në një farë largësie nga pika e rrjedhjes dhe, flaka mund të kthehet mbrapsh në drejtim të burimit fillestar të rrjedhjes.

Gazit të lëngëzuar i jepet një aromë karakteristike duke shtuar në të substanca aromatike përpara se të dalë në treg, në mënyrë që të bëhet i mundur zbulimi i tij nëpërmjet nuhatjes, në grumbullime më të vogla se 1/5 e kufirit të poshtëm të eksplozionit (afërsisht 0,4 % e vëllimit).

#### 4.2. Lëndët ndihmëse.

Në këtë veprimtari nuk përdoren lëndë ndihmëse.

### V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të prodhimit të këpucëve, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

#### 5.1.Shkarkime në ajër.

Proçesi teknologjik i magazinimit dhe tregtimit të naftës, benzinës dhe GLN-së, përfshin disa proçese teknologjike gjatë zhvillimit të të cilëve nuk ka shkarkime në ajër. Pra ndotja është 0.

#### 5.2.Shkarkime në tokë.

Gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie krijohen mbetje të ngurta urbane. Në përbërje të tyre janë plastikë, qelqi, letra/kartoni dhe mbetjet ushqimore. Do të bëhet ndarja selective e këtyre mbetjeve, duke i ndarë ato në lëndë të riciklueshme si metalet, plastika letra/kartoni etj. Dhe në

lloje të pjera mbetjesh të cilat duhet të trajtohen së bashku me mbetjet urbane të zonës së banuar. Metalet, plastikat, letra/kartoni do t'u shiten subjekteve që merren me grumbullimin ose përpunimin e tyre.

### **5.3.Shkarkime të ujërave të ndotur.**

Proçeset teknologjike të këtij subjekti nuk kërkojnë përdorimin e ujit. Kështu, sasia e ujit të përdorur nga ky subjekt është vetëm për plotësimin e nevoja humane të punonjësve. Përfundimisht nga ky subjekt, ujërat që shkarkohen janë të ndotur nga pluhurat dhe mbetje të tjera që mbartin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës si dhe ujëra të zeza.

### **5.4.Shkarkime të zhurmave.**

Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike, në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

## **VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.**

Veprimtaria që vlerësohet në këtë raport, gjendet në ELBASAN. Qyteti i Elbasanit ndodhet në Shqipërinë e Mesme. Ai shtrihet në fushën e Elbasanit, në krahun e djathtë të rrjedhjes së mesme të lumit Shkumbin, i rrethuar në lindje nga Krasta e Madhe dhe e Vogël, në veri dhe veriperëndim nga kodrat e Ullishtave, në perëndim nga përroi i Zaranikës, në jug kufizohet nga lumi Shkumbin. Në anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazderies. Elbasani është i vendosur midis gjerësive gjeografike veriore  $41^{\circ} 27'$ , jugore  $40^{\circ} 10'$ , lindore  $20^{\circ} 34'$  dhe perëndimore  $19^{\circ} 03'$  dhe ndodhet në një lartësi mesatare prej 125 m mbi nivelin e detit. Rajoni I Elbasanit shtrihet në një zonë kodrinore-malore dhe pjesërisht fushore. Zona malore shtrihen kryesisht në very-lindje e jug-lindje dhe zonat kodrinore e fushore në lindje e jug-lindje.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e prodhimit të mobiljeve është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

<b>X</b>	<b>Y</b>
X1 = 4411301.794	Y1 = 4540913.065
X2 = 4411330.871	Y2 = 4540933.316
X3 = 4411363.713	Y3 = 4540927.759
X4 = 4411311.740	Y4 = 4540901.190

Trualli i pazënë me ndërtime nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi. Në të ka elementë infrastrukturë si rrjete furnizimi me ujë të pijshëm, rrjete të shkarkimit të ujërave të ndotur, rrjete

rrugore etj. Ky teritor është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e objekteve të banimit si dhe infrastrukturës dhe elementëve të saj.

### **6.1. Përshkrim të faktorëve klimatikë.**

Klima e rajonit dallohet për diversitetin e saj. Zona fushore dhe kodrinore karakterizohet nga një klimë mesdhetare me verë të nxehtë (26 °C) e dimër të butë (10 °C). Zona malore karakterizohet nga një klimë me verë të freskët (20-23°C) dhe një dimër të lagësht e shpeshherë të ashpër. Reshjet mesatare arrijnë në 1100-1200 mm në vit në zonat e ulëta dhe 1500-2000 mm në vit në zonat malore. Erërat fryjnë në dimër nga verilindja e lindja të ftohta, në verë nga jugperëndimi e perëndimi e veriperëndimi.

### **6.2. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.**

Elbasani ka pasuri të mëdha ujore. Lumenjtë kryesorë janë Shkumbini dhe Devolli. Elbasani shquhet vecanërisht për liqenjtë e tij me origjinë karstike të vendosur në pllajën e Dumresë, të cilët njihen me emrin “Liqenjtë e Belshit”. E tërë zona e Elbasanit është e pasur me burime ujrash nëntokësore, natyralë e sidomos dallohen për cilësinë e tyre gurrat malore me ujin e ftohtë e të pastër. Gjithashtu Elbasani shquhet për burimet termale të llixhave me vetitë curative.

### **6.3. Flora.**

Zona e Elbasanit ka një florë dhe faunë të pasur, të cilat favorizohen nga larmia e klimës ku gjejnë kushtet ideale të gjitha llojet e specieve tipike për zonën e mesdheut. Brezi i shkurreve mesdhetare, Brezi i dushqeve, Brezi i ahut dhe pishes.

Kullotat shtrihet në lartësi 1700-1800 m në malet e Shpatit dhe të Shmilit. Keto bime janë nderthurura me njëra tjetren duke krijuar pyje shumë të bukura. Keto pyje përbejnë dhe pjesën më të rëndësishme të fondit pyjor i cili shfrytëzohet edhe për qëllime industriale. Kullotat e rrethit të Elbasanit janë dimeror dhe verore. Kullotat dimerorendodhet në zonën e ulet të rrethit: Perparim, Pavoje, Paper, Dumre. Kullotat verorendodhet në lartësi të mëdha, mbi brezin e dushkut. Kryesisht ato ndodhet në Shmil, Gjinar, Zavaline.

### **6.4 Fauna**

Rrethi Elbasanit ka një botë shtazore të pasur në shumëllojshmëri. Këto e favorizojnë sipërfaqet e mëdha pyjore, klima e ngrohtë, ujërat e shumta. Me të përhapur janë lepuri dhe dhelpra, të cilat ndodhen në katet e bimesive. Në zonën e shkurreve takojmë cakallin, qelbesin dhe vjerdullën. Në zonat malore të Gjinarit haset derri i eger dhe ariu. Shpendet më të përhapur janë: harabelet, laraska sorra, thelleza e malit dhe fushe, në zonën e Dumresë takojmë shpende migrues si rosa e eger, shapka etj.



Peshqit janë të përhapur në zonën e djathtë të lumit ku përmendim: krapin, ballegjerin, cironken. Ka raste që në liqenet ku realizohet rritja artificiale peshqit arrijnë deri në 30-40 kg.

### **6.5. Cilësia e ajrit në zonë.**

Zona e Elbasanit mund të vlerësohet dhe kategorizohet si zonë me ndikime në mjedis, si për shkarkimet në ajër, treguesit cilësor të ujërave sipërfaqësore dhe të atyre nëntoksorë, nivelit të zhurmave etj.

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në këtë zonë janë nga industria metalurgjike, aktivitetet e linjave të ndryshme prodhuese si dhe nga trafiku i rënduar në zonat urbane, gjatë orëve të pikut. Në ajër ka shkarkime të gazeve CO, SO<sub>2</sub>, H<sub>2</sub>S, CO<sub>2</sub>, H<sub>2</sub>O, NO<sub>x</sub> si dhe plumb, blözë dhe pluhur.

### **6.6. Niveli i zhurmave në zonë.**

Sipas Raportit të Gjendjes së MJedisit, nga matjet e kryera në qytetin e Elbasanit, niveli i zhurmave në disa prej kryqëzimeve të rrugëve kryesore, është mbi normat BE-së.

## **VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.**

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së depozimit dhe tregtimit të naftës, benzinës dhe gazit GLN ka treguar se ka gjenerim të zhurmave si dhe menaxhim të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshi këtu edhe të mbetjeve urbane.

### **7.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme, në mjedis.**

#### ***a. Shkarkime në ajër.***

Proçesi teknologjik i magazinimit dhe tregtimit të naftës, benzinës dhe GLN-së, përfshin disa proçese teknologjike gjatë zhvillimit të të cilëve nuk ka shkarkime në ajër. Pra ndotja është 0.

#### ***b. Gjenerimi i zhurmave.***

Gjatë punës të pajisjeve/makinerve që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike në afërsi të këtyre makinerve/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

#### ***c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.***

Zhvillimi i kësaj veprimtarie shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat janë në formë të mbetjeve të letrës, kartonit, plastikës etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj. çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në lëndfillin e qytetit nga një subjekt i kontraktuar nga bashkia Elbasan.

**d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.**

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë objekt kanë përfunduar ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj.

Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

**e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për t’u shpallur “Peisazh i mbrojtur”.

**f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokëse shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e më sipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të depozitimit dhe tregtimit të naftës, benzinës dhe gazit GLN nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

**7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.**

**a. Vlerësimi i ndikimeve.**

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjrike egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të

identifikuara. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloj ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

#### **b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapsinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

#### **c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

#### **d. Kthyeshmëria**

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

#### **e. Rëndësia.**

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimet më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

#### **f. Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).**

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të depozitimit dhe tregimit të naftës, benzinës dhe GLN-së, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

### **VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.**

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë

relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përkeqësim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

## **IX. ALTERNIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.**

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjrike të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

## **X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).**

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vemendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta që dalin gjatë proceseve teknologjike.  
Gjatë zhvillimit të procese teknologjike në këtë subjekt nuk ka gjenerim të mbetjeve të ngurta.
  - b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat janë në formë të mbetjeve të letrës, kartonit, plastikës etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj. çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në lëndfillin e qytetit nga një subjekt i kontraktuar nga bashkia Elbasan.

## **XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.**

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit European, kryesisht në Itali. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon



sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjije të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

## **XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Në vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjerie (ndërtesë, rrjete inxhinjerie etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe, për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarie.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarie nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

### XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkarkimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet e ujërave në rrjetin e kanalizimeve dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Spektori ku janë instaluar tetoja gjeneratorët
Shkarkimet e ujërave në rrjetin e kanalizimeve	Çdo 6 muaj	Ujërat e pastrimit

-FUND-

*Ernal Banja*



LOERMA SHPK  
NIPT: L02928204T